

Bardhyl Muhadri

Has, Albania

Faleminderit qe edhe net e mbijetuarve na dhate mundesine per te shprehur pikepamjet tona.

Dua te filloj me historine time personale:

Jam viktime minash nga rrethi I Hasit

Kam rene ne Mina ne Vitin 1999, nersa po kullosja bagetine ne kullotat e fshatit.

Si rezultat I renjes ne mine kam hubur kumben e djathe.

Pas Aksidentit me derguan ne Spitalin e Kukesit ku qendrova per rreth dy jave. Me vone me ndihmen e AMAE, ALB-AID, dhe kryqit te Kuq u be e mundur qe une te trajtohesha ne Qendren e Protezave ne Tirane.

Une pata mundesi to punoja per projektin e MRE me shoqaten ALB-AID per nje kohe te gjate nga viti 2002-2006. Me pas, me mbylljen e vendit te punes, une mora trajnim per te filluar biznesin tim per Inseminimin artificial te lopeve. Me mbeshtetjen e ITF dhe te Qeverise une pata mundesi te marr paisjet e duhura dhe materialin e nevojshem per te filluar nje biznes modest me te cilin une tashme jam bere I pavarur dhe siguroj te ardhura per familjen.

Nje mundesi fillestare , trajnimi I duhur dhe mbeshtetja e vazhdueshme ishin shume te rendesishm per mua.

Une pata mundsi te perzgjidhja ate qe kasha mundesi te beja bazuar ne eksperiencat e mepareshem dhe ne te keshillimit nga a na e sghoqates se cfare biznesi mund te ishte I suksesshem.

Isha me fat qe u mbeshteta nga Qeveria dhe nga shoqata per te ktheyr endrren time ne realitet.

Eksperienca ime duhet t'u sherbej si mesim te tjereve . Qeverite duhet te tregohen me te kujdeshme dhe te pergjegjshme per nevojat e te mbijetuarve dhe te sigurojne qe trajnimet fillestare dhe programet mbeshtetese jane te bazuara ne keto nevoja. Gjithashtu qeverite duhet te sigurojne dhe te ndjekin punen e bere ne menyre iniciativat e marra nga te bi-jetuarit te jene te suksesshme

Une isha me fat qe u angazhova ne mbareshtimin e blektorise, aktivitet I cili ka mbeshtetjen e Qeverise Shqiptare . Po qeverite duhet te sigurojne qe te mbeshteten edhe iniciativat e ndryshme te te mbijetuar te tjere , te sigurohet qendrueshmeria e programeve te tilla per nje kohe te gjate.

Por pervec mbeshetjes se Qeverive per programe dhe iniciativa te tilla, ne mendojme se akoma eshte e domosdoshme mbeshtetja nderkombetare per aktivitete te tilla punesimi dhe gjenerimi te ardhurash.

Dua gjithashtu te theksoje rendesine qe ka per ne rritja e aksesit ndaj munesive te ndryshme per te qene te suksesshem

Shqipria ka patur nje Spital Rajonal prane ish zonave te minuara, prandaj edhe te mbijetuarit kishin mundesi te merrnin ndihmen e duhur sa here qe kerkohet nga ata.

Per me teper, kur une kame patur nevoja te tjera psh per protezim, Une me ndihmen e ALB-AID dhe AMAE me mbeshtetjen e ITF jam derguar ne Tirane dhe me pas ne Slloveni prane Insitutit te Rehabilitimit.

Tani sic ju e pate edhe dje, Spitali I Kukesit ka nje Repart protezimi , keshtu qe ne nuk kemi nevoje te shojme gjetke per te mirembajtur ptotezat. Por une u jam mirenjohes donatoreve se para ekzistences se nje Pavioni te tille, me mundesuan qe une te kem proteza cilesore, dhe kjo beri qe jeta ime te ndryshoje.

Tani fjalen ia le Zelkos nga Bosnja per te folur per perseptiven e tije per rendesine e mbeshtetje se Sociale per zbatimin e Traktatit te ndalimit te minave dhe te detyrimeve te tjera nderkombetare

Faleminderit